

## Kombetarja/ Te henen ne mengjes drejt Islandes

nga AlbaniaSoccer  
E diel, 08 Shtator 2013 21:16

---



Kombetarja e Shqiperise i ka mbyllur ditet e qendrimit ne Lubjane. Do te largohet nga Sllovenia te henen ne mengjes per te marre rrugen drejt Rekjavikut. Te marten ne oren 21:00, kuqezinjte do te luajne ndaj Islandes takimin e rradhes per kualifikueset "Brazil 2014". Delegacioni shqiptar do te udhetoj per disa ore nga Lubjana drejt Islandes me nje avion carter qe do ti ofroje skuadres komoditetin e nevojshem per te mberritur ne destinacion. Ne mbremje, ne oren 20:00 pritet qe skuadra e drejtuar nga De Biazi te zhvilloje te paren dhe te fundit stervitje ne stadiumin ku do te luajne ndaj islandezeve.